



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **17.04.2025**, me fillim në orën **10:15**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuar nënkryetar i komunës, **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë ju të pranishëm. E hapim mbledhjen e **katërt (4)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2025. Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë rend dite;

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i draft-rregullores për transparencë në Komunën e Rahovecit;
3. Shqyrtimi i raportit financiar, janar – mars 2025.
4. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP);
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-08152-0, ZK-Rahovec;
6. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-08152-0, ZK-Rahovec;
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënie të pronës me qira P-01496-0, ZK-Retijë;
8. Shqyrtimi i vendimit për formim të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-01496-0, ZK-Retijë;
9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-08994-0, ZK-Rahovec;
10. Të ndryshme.

Shtesë:

11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor).

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, fillimisht e kemi edhe një pikë shtesë: **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor).** Besoj që kur të kthehet drejtori gjatë mbledhjes do ta sponsorizojë. Atëherë kush është “për” që kjo pikë t’i bashkohet rendit të ditës për sot? Unanimisht (6) aprovohet futja në rend dite. Tani rendin e ditës e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht (6) votohet rendi i ditës për sot.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: Nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (5), votohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i draft-rregullores për transparencë në Komunën e Rahovecit:

Nënkryetari: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, para vetes e keni draft-rregulloren për transparencë në Komunën e Rahovecit. Rregullorja përcakton rregullat që sigurojnë transparencë të punës së organeve komunale, kryetarit, drejtorive, kuvendit, trupave të kuvendit dhe mekanizmave të tjerë. Ju ftoj që ta votoni për në kuvend.

Kryesuesi: Nëse dikush ka ndonjë rreth pikës së dytë? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (5), votohet pika e dytë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i raportit financiar, janar – mars 2025:

Afrim Limani: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për anëtarët e KPF-së. E kemi raportin financiar tremujor, janar-mars 2025, i cili përmban të hyrat vetanake, planifikimin dhe realizimin e tatimit në pronë 2025/2024 si dhe dallimet në mes të periudhave të njëjta të viteve paraprake. Raporti e ka edhe realizimin e buxhetit, shpenzimet sipas drejtorive dhe sipas kategorive ekonomike, e keni të paraqitur në mënyrë grafike. Raporti gjithashtu përmban raportin e kontratave të nënshkruara në vitin 2024, si dhe obligimet e papaguara financiare në kategorinë mallra dhe shërbime dhe në shpenzime kapitale. Raportin e keni të paraqitur në mënyrë të detajuar.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Nëse dikush ka ndonjë rreth pikës së tretë? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (5), votohet pika e tretë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP):

Kryesuesi: Në mungesë të drejtorit të Arsimit, po mundohet ta sponsorizoj unë. Vendimi ka të bëjë që të caktohet një komision, i cili e ka për detyrë t’i përzgjedh drejtorët dhe zv.drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore. Nëse dikush ka ndonjë pyetje, urdhëroni! Atëherë, po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht (6) votohet edhe pika e katërt.

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-08152-0, ZK-Rahovec:

Nënkryetari: Në mungesë të drejtorit Afrim, po e prezentoj unë shkurt. Vendimi ka të bëjë për dhënien afatshkurtër me qera të pronës komunale me numër 08152-0 në zonë kadastrale në Rahovec, në vendim e quajtur Rimnik. Është arë e klasës së katërt me sipërfaqe 2762m².

Kryesuesi: Faleminderit nënkryetar! A ka dikush diçka rreth kësaj pike?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (5), votohet pika e pestë e rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-08152-0, ZK-Rahovec:

Kryesuesi: Sa i përket komisionit për zbatimin e procedurave për pronën e lartëcekur, është procedurë që të zgjidhet në kuvend. Komisioni i ka pesë anëtarë dhe ju ftoj që kjo pikë të cedohet tutje. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (5), votohet pika e gjashtë e rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënie të pronës me qira P-01496-0, ZK-Retijë:

Nënkryetari: Faleminderit kryesues! Bëhet fjalë për pronë të paluajtshme me certifikatë të pronësisë 01496-0 në sipërfaqe prej 68.838m², nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës, 137.354m². Qëllimi ka të bëjë me ruajtjen dhe rritjen e vlerës së pronës komunale.

Kryesuesi: Faleminderit nënkryetar! A ka dikush diçka rreth kësaj pike?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (5), votohet pika e shtatë e rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i vendimit për formim të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-01496-0, ZK-Retijë:

Nënkryetari: Gjithashtu kjo parcelë do ta ketë edhe komisionin prej pesë anëtarësh, që do të zgjidhet në mbledhjen e rregullt të kuvendit.

Kryesuesi: Faleminderit nënkryetar! A ka dikush diçka rreth kësaj pike?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (4), votohet pika e tetë e rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-08994-0, ZK-Rahovec:

Kryesuesi: Meqë tani është i pranishëm drejtori Afrim Oruqi, e ftojme që ta sponsorisojë pikën.

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, anëtarë të KPF-së. Bëhet fjalë për zonë kadastrale në Rahovec, në sipërfaqe prej 12m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 461m², e vlerësuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Salih (Sylejman) Haxhijahës. Qëllimi ka të bëjë me zgjerimin e rrugës publike “Halil Hamza” – 1433-0.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush diçka rreth kësaj pike?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (4), votohet pika e nëntë e rendit të ditës.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor):Afrim

Afrim Oruqi: Me këtë vendim miratohet kërkesa e qytetarëve të lagjes për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor (të drejtës së kalimit) në pjesën e parcelës publike kadastrale sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-01355-4, në zonën kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej 7m² (shtatë metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 6880m² (gjashtëmijë e tetëqind e tetëdhjetë metra katror). E drejta e kalimit e ka gjerësinë 5m dhe gjatësinë e përgjithshme 94.98m.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush diçka rreth kësaj pike?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (5), votohet pika e dhjetë e rendit të ditës.

11. Të ndryshme:

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, kemi arritur te pika e fundit e mbledhjes së sotme. Nëse keni diçka për të shtuar?... Nëse jo, atëherë ju falënderoj për vëmendjen dhe shihemi në mbledhjen e rregullt të kuvendit.

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi

